



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave
“Fizioterapi klinike”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aldent”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Migena Kika

2. Prof.asc. Manika Kreka

Shkurt/ 2024

Raport i grupit të vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Master i Shkencave në “Fizioterapi klinike” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aldent”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Aldent
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i shkencave në “Fizioterapi klinike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 195, datë 28.05.2013
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UQSHA Nr.125, datë 07.09.2018
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 37, datë 13.07.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	21 PAE/ 11 PAK
18	Numri i studentëve: (2020-2023)	57 Studentë
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në kuadrin e akreditimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Fizioterapi Klinike” kërkuar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aldent”, është realizuar procesi respektiv i vlerësimit sipas agjendës së miratuar nga dy institucionet. Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet që kanë dalë si rezultat i analizës për procesin e vlerësimit të jashtëm. Universiteti “Aldent” (UAL) është institucion jo publik i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 673, datë 22.09.2006, me statusin Shkollë e Lartë Universitare. Përgjatë viteve ky IAL ka pësuar një sërë ndryshimesh si në emërtim dhe në strukturën e tij. Me VKM Nr. 539, datë 13.06.2013, ndryshon statusi nga shkollë e lartë universitare private “Aldent” në Universitet, me emërtimin Universiteti “Aldent”. Me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 305, datë 24.07.2013, riorganizohet institucioni në 2 Fakultete, në përputhje me Vendimin Nr. 442, datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit. UAL ka kaluar disa procese vlerësimi dhe akreditimi të njësive kryesore si dhe te akreditimit institucional. Me Urdhër të MAS Nr. 115, datë 13.07.2017 hapet Njesia Kryesore Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Me UMASR Nr. 111, datë 11.03.2016 Universiteti Aldent ka kaluar akreditim periodik institucional, në përputhje me Vendimin Nr. 124, datë 18.02.2016 të Këshillit të Akreditimit. Institucioni ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA të finalizuar me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.114, datë 15.12.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike, me afat vlefshmërie deri në 14.12.2022.

Akredituar me VBA Nr.1, datë 27.01.2023 me kohëzgjatje 5 vite, vlefshmëri deri më 26.01.2028.

Struktura akademike e Universitetitv “ALDENT”, aktualisht përbëhet nga tre njësi kryesore:

1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore me:

- Departamenti i Farmacisë;
- Departamenti i Formimit Mjekësor;
- Qendra Kërkimore Farmako-Terapeutike;

2. Fakulteti i Shkencave Dentare me:

- Departamenti i Laborantëve Dentarë;
- Departamenti i Stomatologjisë;
- Qendra e Shërbimit dhe Formimit Klinik;

3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike me:

- Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë;
- Departamenti Laborant Mjekësor dhe Imazheri;
- Qendra e Promovimit të Shëndetit;

Programi i studimit Master i Shkencave në “Fizioterapi Klinike” në Univesitetit ALDENT ofrohet nga Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore

Teknike është licensuar nga MASR me urdhër Nr.195 në datën 28.05.2013 për “Hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë”. Ka kaluar akreditimin e parë me urdhër Nr. 37, datë 13.07.2018, për “Akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të dytë Master i shkencave në “Fizioterpi klinike” të universitetit “ALDENT”.

Sipas njësisë bazë që e ofron ky program është bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe ka patur në konsideratë këtë nevojë që kanë profesionistët për t’u punësuar në të ardhmen në vende të tjera. Programi Master i Shkencave në “Fizioterapi Klinike” është organizuar në respekt të legjislacionit arsimor në momentin e liçensimit dhe akreditimit të parë dhe është përshtatur e përditësuar në zbatim të vendimit Nr 41, datë 24.01.2018 dhe të gjitha akteve nënligjore të mëpasme.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i vlerësimit të jashtëm përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve të ciklit të dytë për Masterin e Shkencave, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive. Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura, janë shqyrtuar një sërë dokumentesh dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. I gjithë dokumentacioni i referuar është ngarkuar nga institucioni në AMS. Procesi i vlerësimit është administruar nga Koordinatorin teknik nga ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS.

ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UAL, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Dr. Migena Kika, dhe Prof. asc. Manika Kreka. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Aviola Bardhi.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

Vlerësimi i brendshëm ku institucioni ka dorëzuar Raportin e vlerësimit të brendshëm së bashku me dokumentacionin mbështetës (DVB). Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimit dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive. Vizita në UA e zhvilluar në datat dhe 26 dhe 27 Qershor 2023. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit. Raporti i vlerësuesve të jashtëm bazohet në dokumentacionin e dorëzuar nga UAL, informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit të cilat kanë ndihmuar në arritjen e konkluzioneve mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi.

Më datë 22.01.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 47/1 Prot., datë 22.01.2024, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti “Aldent”, kthehu përgjigje në sistemin AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 6 Prot., datë 23.01.2024.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 37, datë 13.07.2018 datë janë:

1. Institucioni të marrë masa për mbulimin e pozicionit të drejtuesit të njësisë kryesore në përputhje me kërkesat në fuqi për këtë pozicion.
2. Institucioni të shohë mundësinë e rekrutimit të stafit të ri akademik me grada dhe tituj dhe/ose të nxisë stafin akademik aktual të angazhuar në këtë program studimi në marrjen e gradave shkencore/titujve akademike.
3. Institucioni të mbajë në vëmendje në të ardhmen ngritjen e një klinike fizioterapeutike, për shërbim ndaj të tretëve, për njohjen e studenteve me shumëllojshmeri të rasteve klinike dhe ushtrimin e profesionit në aspektin praktik.

Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni:

1. Universiteti "ALDENT" ka dëshmuar se për vitin akademik 2018-2019 ka emëruar si Dekane të Fakultetit të shkencave mjekësore teknike me datë 05.10.2018 Prof.asc. Lindita Grimci.

Aktualisht Dekane e FSHMT është Prof.asc. Klodiola Dharmo emëruar nga rektori në datë 22.11.2022 me të cilën patëm takime gjatë vizitës.

2. Institucioni ka deklaruar se deri në vitin akademik 2017- 2018 nuk ka patur asnjë fizioterapist me titull apo gradë shkencore në vendin tonë për shkak të pezullimit të mbrojtës së doktoraturave në UMT. Nga tabelat e paraqitura konstatohet që ka staf me Msc. fizioterapistë dhe specialistë të fushës, por që janë të angazhuar në modulet rehabilituese. Konsiderohet i plotësuar si rekomandim edhe me argumentin e institucionit por edhe me logjikën që studentët duhet të marrin njohuri nga specialistë të fushës që janë kompetent edhe pse nuk kanë titull dhe mbi të gjitha duke patur parasysh faktin që fizioterapia përfshihet në shkencat mjekësore teknike ku duhet të mbizotërojnë njohuritë e marra nga specialistë të fushës së rehabilitimit. Gjë që praktikohet më së shumti edhe në programe të të njëjtit cikël në vende europiane, ku ne si profesionistë kemi ekspertizë. (Ev.7)

3. Universiteti "ALDENT" ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa spitale universitare si QSUT, Spitali i Traumës, Spitali universitar "Shefqet Ndroqi" si dhe klinika të shumta fizioterapeutike ku studentët kanë mundësi të njohin dhe të asistojnë rehabilitimin e rasteve të shumta klinike duke patur kështu mundësinë të kenë një formim të plotë profesional. Marrëveshjet janë marrë si evidenca të RVB, gjithashtu janë konfirmuar edhe në takimet e bëra gjatë vizitës në institucion.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i shkencave në Fizioterapi klinike

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Institucioni e ofron këtë program studimi në përputhje me interesat kombëtare si dhe përcjell modele akademike dhe profesionale që konsiderohen vlera të shtuara për vendin dhe mbi të gjitha në fushat mjekësore. UAL dëshmon se ruan dhe konsolidon vlerat kulturore kombëtare siç janë gjuha, historia, simbolet kombëtare gjë që e kanë reflektuar edhe në logon e tyre. (Evidenca. 4)			
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Master i shkencave në fizioterapi klinike është në linjë me synimet dhe misionin e institucionit ashtu sikundër paraqitet në statutin e institucionit. Universiteti ka një focus të qartë me drejtim vetëm mjekësor dhe gjatë takimeve me drejtuesit u konfirmua strategjia e zhvillimit të tyre.			
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Universiteti Aldent në strategjinë e vet të zhvillimit ka të përcaktuar prioritetet e zhvillimit të programeve që ofron. Institucioni ka përcaktuar prioritetet e zhvillimit të programeve në tërësi dhe ka një harmoni të dokumentave rregullatorë. (Evidenca.5)			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Institucioni dëshmon se ka një përvojë 20 vjeçare në arsimin e lartë dhe një focus të qartë në drejtimin të ofrimit të programeve të të treja niveleve vetëm në fushat mjekësore. Niveli i programit është në përputhje me nivelin 7 të kualifikimit të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit (KSHK), dhe zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe zhvillimet ndërkombëtare.			
Konkluzione	Nga RVB, dokumentacioni i dorëzuar bashkëlidhur GVB si dhe nga vizita në institucion dëshmohet se ALDENT ruan dhe konsolidon vlerat kulturore kombëtare. Programi është në linjë me objektivat institucionale. Ka një strategji zhvillimi ku janë përcaktuar prioritetet të cilat jënë në harmoni me fokusin mjekësor që ka njësia.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësise kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Universiteti Aldent demonstroi një eksperiencë 20 vjeçare dhe dëshmon me evidence se plotëson të gjitha kriteret ligjore të infrastrukturës dhe burimeve njerëzore dhe kujdeset vazhdimisht për rritjen e cilësisë akademike duke angazhuar staf të specializuar konkretisht për këtë program studimi.
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësise kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit të ciklit të dytë Msc në “Fizioterapi klinike” ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe është pjesë e strukturës së programeve të studimit që ofron UAL në fushën e shkencave mjekësore. Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me drejtimin e përcaktuar të institucionit, njësive dhe kapaciteteve logjistike dhe burimeve njerëzore të orientuara në bazë të specifikave të njësise.
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësise bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitet bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Ky program studimi organizohet nga Departamenti Infermieri dhe Fizioterapi që gjithashtu ofron edhe programin e ciklit të parë Bachelor në Fizioterapi, pra është në përputhje me fushën akademike të njësise bazë që e ofron këtë program. (Evidenca.6.1) (Evidenca.6.2)
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Ky program është në të njëjtin drejtim të institucionit.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Kryesisht për studentët e fizioterapisë Institucioni konfirmoi me evidence dhe me dëshmitë e studentëve dhe stafit, gjithashtu vihet re dhe në rrjetet e tyre sociale se organizon vazhdimisht trajnime dhe specializime për metoda të ndryshme rehabilitimi me trajnerë të huaj dhe jo vetëm që sot për sot janë më të avancuarat në këtë fushë.
Konkluzione	<i>Programi i studimit Msc në Fizioterapi klinike sipas dokumentacionit dhe vërtetimit në vend organizohet nga njësia bazë dhe kryesore që ofron programe të të njëjtës fushë dhe ka kapacitete për ta ofruar me cilësi këtë program.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Në statutin e Universitetit "ALDENT" është përcaktuar struktura organizative e institucionit sikurse njësitë përbërëse me funksionet e kompetencat, vendin që zënë në strukturë, lidhjet e varësitë që kanë ndërmjet tyre, personelin që i përbëjnë. <i>(Evidenca. 4)</i> Në rregulloren e njësisë kryesore dhe departamentit janë përshkruar ndarja e detyrave dhe përgjegjësisë për secilin pozicion. Në strukturën e njësisë bazë është ngarkuar një koordinator didaktik (përgjegjësi i programit) i cili menaxhon lidhjet midis subjekteve të brendshme dhe të jashtme të përfshirë në procesin mësimor. <i>(Evidenca. 7)</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Për realizimin efektiv të procesit mësimor teorik dhe praktik UAL dëshmoi se bashkëpunon si me institucione arsimore homologe vendase dhe të huaja, po ashtu edhe me institucione shëndetësore publike dhe private në vend. Prioritet i është dhënë sidomos bashkëpunimit me Universitetin e Mjekësisë Tiranë nisur nga fakti që janë të vetmit universitetet në vend të specializuara vetëm në drejtim mjekësor. Gjithashtu dëshmuar se kanë marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi të cilat shprehen me shumë në shkëmbim reciprok të stafit, organizimin konferencave dhe aktiviteteve akademike të përbashkëta.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Për realizimin e praktikave klinike UAL ka marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione spitalore në Tiranë si QSU "Nënë Tereza", Spitali Ortopedik- Traumatologjik, Spitali Obstetrik Gjinekologjik "Koço Gliozheni", Spitali universitar "Shefqet Ndroqi" etj. si dhe mjaft klinika fizioterapie të cilat i kishim në tabela dhe si dokumenta të bashkëlidhur raportit. <i>(Evidenca. 7, 25)</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin	Koordinatori i programit të studimit, përgjegjësi i Departamentit si dhe zyra e bashkëpunimeve kryejnë raporte periodike për eficientësinë dhe

e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	aktivitetet e kryera në bashkëpunim me institucionet homologe të kryera si dhe mbikqyr praktikat klinike nëpërmjet stafit fizioterapist të cilët raportojnë rregullisht për realizimin e planit mësimor teorik e praktik si dhe arritjen e objektivave të paracaktuara për rehabilitimet. (Evidenca.10)			
Konkluzione	<i>Për realizimin efektiv të procesit mësimor teorik dhe praktik UAL dëshmoi se bashkëpunon si me institucione arsimore homologe vendase dhe të huaja, po ashtu edhe me institucione shëndetësore publike dhe private në vend. Kanë marrëveshje bashkëpunimi me të gjithë spitalet publike në Tiranë si dhe me shumë klinika fizioterapie gjë që u konfirmua më së shumti nga studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Në bazë të dokumentacionit të paraqitur programi është i organizuar në module dhe lëndë të kategorizuara mbi bazën e veprimtarisë formuese, duke i ndarë ato në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese. Bazuar në kategorizimin e lëndëve, numri më i lartë i krediteve (ECTS) është vendosur në dispozicion të lëndëve karakterizuese. <i>(Evidenca. 7)</i> Pesha që zë secila kategori e veprimtarive formuese brenda programit të studimit paraqitet në tabelat shoqëruese.
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Struktura e programit të studimit sipas dokumentacionit dhe dëshmimeve të drejtuesve të njësive si dhe takimeve me zyrën e kurrikulës është bazuar në praktikatat më të mira dhe lëndët/ modulet përbërëse synojnë të sigurojnë njohuritë themelore nëpërmjet integritit të mësimi teorik dhe praktik. Modulet/ lëndët që ofrohen ju sigurojnë studentëve një përgatitje të gjerë dhe mundësi që të përshtaten në tregun e punës dhe në studimet e mëtejshme. Në programin e studimit janë përfshirë module karakterizuese dhe të përgjithshme të fushës së fizioterapisë të cilat iu krijojnë studentëve koncepte dhe aftësi të lidhura me specialitetin e tyre. Programi i studimit përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e një programi studimi sipas ligjit 80/2015, VKM nr.41. datë 24.01.2018 i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore. Është organizuar sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), realizohet në 2 vite studimi / 4 semestra, me 120 ECTS në total dhe është i strukturuar në grup-lëndë sipas kategorive të formimit duke respektuar kërkesat e kuadrit ligjor. <i>(Evidenca. 7)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Në planim mësimor është përcaktuar ngarkesa në kredite dhe orë për detyrimet përmbyllëse të praktikës profesionale dhe mbrojtjen e diplomës. Programi përmban lëndë 180 kredite ECTS në total, duke përfshirë provimin përfundimtar/ diplomën 7 ECTS.
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”.	Këto kritere nuk i përkasin këtij programi studimi.

sipas fushave përkatëse të formimit.	
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Universiteti Aldent është një insitucion i arsimit të lartë, jopublik (jo me status të veçantë) i cili organizohet dhe ushtron veprimtari akademike, kërkimore dhe shkencore konform ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi për arsimin e lartë.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Vërtetohet se programi i studimit Msc në “Fizioterapi klinike” ka të njëjtën emërtesë dhe pothuajse përmbajtje me programe të të njëjtës fushë në vendin tonë dhe më gjerë. Këtë e dëshmon fakti që shumë studentë të diplomuar në UAL kanë njohur studimet dhe janë punësuar pa detyrime teorike dhe praktike nga programi i studimit.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Nisur nga detyrimi ligjor në nenin 86, pika 1 e LAL si dhe udhëzimit 31 datë 15.12.2022, Universiteti dëshmoi se ka propozuar kodifikimin në MAS për të gjitha programet e studimit që ofron me shkresë nr 22 prot. Datë 31.03.2023. Gjithashtu institucioni dëshmoi se në sistemin e brendshëm të menaxhimit të sekretarisë FxEducation ka një kodifikim të programeve të studimit si dhe lëndëve/ moduleve për çdo program.
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk është program i përbashkët.
Konkluzione	<i>Struktura e programit të studimit sipas dokumentacionit dhe dëshmive të drejtuesve të njësisë si dhe takimeve me zyrën e kurrikulës është bazuar në praktikat më të mira dhe lëndët/ modulet përbërëse synojnë të sigurojnë njohuritë themelore nëpërmjet integritit të mësimit teorik dhe praktik. Programi i studimit përmban të gjithë elementët që përbëjnë</i>

	strukturën e një programi studimi sipas ligjit 80/2015, VKM nr.41. datë 24.01.2018 i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore. Është organizuar sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), realizohet në 2 vite studimi / 4 semestra, me 120 ECTS në total dhe është i strukturuar në grup-lëndë sipas kategorive të formimit duke respektuar kërkesat e kuadrit ligjor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	FSHMT në UAL si dhe Departamenti Infermieri dhe Fizioterapi që ofron këtë program është organizuar në zbatim të LAL, neni 43, 45. Sikurse evidentohet në organigramën e institucionit FSHMT përbëhet prej 3 njësive bazë: 1. Departamenti Infermieri dhe Fizioterapi 2. Departamenti Teknik Laboratori dhe Imazheri 3. Qendra e promovimit të shëndetit. Dekani i FSHMT në UAL mban titullin Prof.asc. Dhe drejtuesit e njësive bazë mbajnë titullin Doktor i shkencave. Departamenti Infermierisë dhe Fizioterapisë për vitin akademik 2022-2023 është i përbërë nga 17 staf efektiv nga të cilët: 3 Prof As, 4 Dr, 10 Msc dhe 19 staf me kontratë nga të cilët: 1 Prof.As, 8 Dr, 4 Spa, 6 Msc. (17 PAE dhe 19 PAK); (Evidenca.7, tab 2)
Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik / administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Departamenti Infermieri dhe Fizioterapi ka të angazhuar staf fizioterapist që gjithashtu ushtrojnë edhe profesionin në spitale apo klinika fiziooterapie. Përveç stafit me kohë të plotë, DIF në kuadër të marrëveshjeve me spitale, angazhon për monitorimin e studentëve edhe staf fizioterapist në shërbimet ku studentët kryejnë praktikat klinike.
Kriteri 3. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	FSHMT dëshmon se ka angazhuar për çdo program studimi një koordinator didaktik (përgjegjës programi) që kryen një sërë funksionesh me qëllim mbarëvajtjen e procesit mësimor si: Ndërtimin e orarit sipas planit mësimor dhe kronologjisë së lëndëve, në bashkëpunim me të gjithë pedagogët; Orientimin e studentëve në lidhje me mësimdhënien, oraret, praktikat Monitorimin periodik dhe ndjekjen e procesit mësimor si dhe komunikon në mënyrë të vazhdueshme me drejtuesin e Departamentit, Dekanin dhe cdo person tjetër që lidhet me problematikën që adresohet dhe përpilon një raport përmbledhës vjetor

	në fund të vitit akademik gjë që na u konfirmua nga stafi akademik dhe vet koordinatori e këtij programi R.S. (Evidenca.6.3.1)			
Konkluzione	FSHMT në UAL si dhe Departamenti Infermieri dhe Fizioterapi që ofron këtë program është organizuar në zbatim të LAL. Dekani i FSHMT në UAL mban titullin Prof.asc. Dhe drejtuesit e njësive bazë mbajnë titullin Doktor i shkencave. FSHMT dëshmon se ka angazhuar për çdo program studimi një koordinator didaktik si dhe ka angazhuar staf akademik dhe mbështetës për mbarëvajtjen e programit			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Departamenti Infermieri dhe Fizioterapi referuar dokumentacionit aktualisht ofron 2 programe studimi të ciklit të parë dhe dy programe studimi të ciklit të dytë. Referuar rregulloreve në departament disponohet gjithë dokumentacioni i nevojshëm që lidhet me këtë program studimi që përfshin planet mësimore sipas cikleve akademike të cilat ishin bashkëlidhur si evidencë RVB.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/ moduleve, orët në auditor/ jashtë auditorit.	Plani mësimor ishte i hartuar në mënyrë të detajuar me të gjithë elementët e mësimdhënies të ndarë sipas viteve, semestrave, lëndëve, moduleve, kredite të konvertuara në orë kontakti dhe orë të vetëpërgatitjes së studentëve.
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Dokumentat e programit, përmbanin informacion për kriteret e pranimit, procedurën e njohjes dhe transferimit të studentëve dhe çdo informacion tjetër që konsiderohet i nevojshëm për studentët. (Evidenca.6.4) Pavarësisht se regjistrimi dhe transferimi i studimeve rregullohen me akte të përvitshme të MASR, institucioni ka parashikuar procedurën që si kryhen transferimet e studimeve dhe kriteret e përzgjedhjes e cila ishte si evidencë dhe u konfirmua. (Evidenca.12.1)
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë	Në dokumentacionin e programit që na u vu në dispozicion përfshihehin syllabuset e lëndëve/ moduleve të detajuara me të gjithë komponentët e nevojshëm të parashikuar në VKM Nr 41, datë 24.01.2018. Syllabuset e moduleve përmbajnë literaturën e detyruar dhe të këshilluar, detyrimet dhe të drejtat e studentëve gjatë zhvillimit të modulit, mënyrën e pikëzimit dhe formën e kontrollit të dijes që sipas stafit dhe studentëve u prezantohej studentëve në orën e parë të mësimi. (Evidenca.11)

auditorit në përputhje me formatet e miratuara.			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Nga zyra e kurrikulave dhe stafi i programit u evident që programi i studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm, përfshirë këtu, syllabuset, literaturën etj. Ky proces iniciohej nga njësia bazë e cila kërkonte në përfundim të çdo viti akademik nga pedagogët të kryejnë ndryshime eventuale (nëse ka) në syllabuset e lëndëve/moduleve nën masën 20% në përputhje me aktet në fuqi. Programi Msc në Fizioterapi klinike nuk ka bërë ndryshime sasiore në module/ lëndë por, pedagogëve u është kërkuar të përditësojnë materialet me literaturë të 5 viteve të fundit.		
Konkluzione	Departamenti përmban gjithë dokumentacionin e nevojshëm sipas kriterëve ligjorë që na u vu në dispozicion paraprkasht bashkëlidhur me RVB por që gjithashtu u konfirmua dhe u evidentua gjatë vizitës tonë në institucion.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Nga shqyrtimi i syllabuseve u evidentua se: - Emërtimet e moduleve/ lëndëve ishin të njohura dhe nënkuptojnë njohuritë që do të merren gjatë zhvillimit të tyre. - Përmbajtja e elementëve të mësimdhënies, ngarkesa, objektivat dhe qëllimet, tematikat dhe literatura ishin të përshkruara qartësisht dhe mundësojnë marrjen e njohurive. - Praktikat rehabilituese janë një komponent i rëndësishëm i formimit profesional ndaj i kushtojnë një vëmendje të veçantë.
Kriteri 2. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektiveve formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërimit shkencor.	Nga dokumentacioni dhe nga takimet gjatë vizitës u konfirmua se shpërndarja e disiplinave në vite studimi është realizuar në mënyrë të tillë që mundëson arritjen e objektivave. Në program janë parashikuar lëndët dhe kreditet përkatëse, po ashtu dhe organizimi i tyre në orë mësimore dhe studim individual. Shpërndarja e krediteve është bërë referuar udhëzimeve dhe rregullave, të vendosura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe aktet nënligjore në fuqi.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në	Lëndët në këtë program studimi ishin grupuar sipas veprimtarive të parashikuara në legjislacion dhe respektonin raportet e formimit teorik dhe atë praktik. Raport ky që respektohet edhe në programe të ngjashme në vendet ku zbatohet sistemi i Bolonjës. (Evidenca.7)

rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.				
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Programi mësimor është përpiluar duke patur në vëmendje formimin gradual të studentëve sikurse në programe të njëjta ose të përafërta të ofruara në institucione homologe në mënyrë që të lehtësohet njohja dhe transferimi i krediteve pa humbur kohë dhe njohuri gjatë këtij procesi.			
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Në syllabuse vihen re dy rubrika të detyruara që janë literatura e detyruar dhe e rekomanduar për zhvillimin e modulit, e cila rekomandohet nga departamenti të përditësohet çdo vit akademik duke respektuar fushën e modulit. <i>(Evidenca.11)</i>			
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi garanton për studentët përgatitje të lartë teorike dhe praktike dhe i jep mundësinë profesionistëve të angazhohen në trajnime profesionale në kuadër të përvetësimit të njohurive për specialitete të veçanta në klinika apo qendra spitalore si dhe të synojnë për thellimin e njohurive në cikle më të larta studimi.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Është indikator mjaft i rëndësishëm fakti që shumica e studentëve të këtij programi kishin përfunduar në Aldent edhe ciklin e parë Bachelor në Fizioterapi dhe ishin totalisht të punësuar në profesion. Kjo e bën procesin mësimor dhe veprimtaritë e tjera të zhvillohen me seriozitet pasi ata janë më kërkues ndaj personelit akademik dhe ndaj vehtes.			
Konkluzione	Nga dokumentacioni dhe nga takimet gjatë vizitës u konfirmua se struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Universiteti Aldent ka objektiv ofrimin e programeve mësimore të përditësuara dhe të përshtatura me kërkesat e tregut të punës. Për këtë qëllim programi mësimor mund të ndryshohet deri në masën 20% pas një propozimi dhe argumentimin në senatin akademik. Numri i lartë i studentëve dhe prezenca e tyre në institucion shëndetësorë krijon mundësitë e njohjes dhe prezantimit të tyre me mundësi punësimi në të ardhshëm. Në këtë kuadër kjo është mjaft favorizuese në punësimin e studentëve. Shumica e studentëve të fakultetit punësohen pa përfunduar studimet si rezultat i rekomandimeve dhe mbështetjes së dhënë nga personeli akademik. <i>(Evidenca.12.0)</i>			
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Studentët janë të përfshirë me përfaqësi në struktura të ndryshme të institucionit si Senati akademik, Njsbc, komisione të përhershme etj. sipas paarshtimeve ligjore ku japin mendime dhe bëhen pjesë e vendimarrjes. Ata gjithashtu përfshihen në grupet e punës në proçese akreditimi duke u aktivizuar seriozisht në këto proçese. <i>(Evidenca.19)</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Departamenti Infermieri dhe Fizioterapi mban kontakte me Urdhërin e Infermierit, shoqatat dhe institucione të tjera për përditësimin dhe përshtatjen e objektivave të programit dhe moduleve me direktivat dhe kompetencat e të gjitha niveleve që priten të aprovohen dhe shpallen nga Ministria e Shëndetësisë. <i>(Evidenca.7, tab 7)</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni dëshmon se studentët janë të përfshirë në struktura të ndryshme si dhe ka marrëdhënie të frytshme me instutucione të bashkëpunimit në funksion të përmirëimit të cilësisë akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në	Në dokumentat e programit dhe nga takimet u afirmua se prioritet i programit të studimit është formimi i fizioterapistëve të aftë për të marrë përgjegjësi në menaxhimin e situatave komplekse jo vetëm si profesionistë por mbi të gjithë si njerëz me vlera të larta humane. <i>(Evidenca.6.4)</i>

përputhje me objektivat madhorë të institucionit.				
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Sipas rregulloreve dhe gjithë dokumentacionit mbështetës, departamenti organizon dhe administron procesin akademik duke respektuar lirinë akademike të stafit që shprehet në tematikat e lëndës, literaturën e përdorur si dhe mënyrën e organizimit të mësimdhënies nisur nga karakteristikat e modulit. Shpërndarja gjatë vitit akademik e orëve të teorisë dhe praktikave bën të mundur ndërthurjen e dijeve dhe siguron mundësi për mbledhjen e të dhënave klinike. Gjithashtu nga studentët u aprovua se gjatë vitit akademik organizohen aktivitete kulturore dhe sportive siç janë ekskursionet dhe kampionatet sportive brenda UAL dhe ndëruniversitare ku këta studentët janë shumë aktivë.			
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi përfshin orë detyrash dhe projekte që zhvillohen nën kujdesin e institucionit duke shfrytëzuar kapacitetet dhe marrëdhëniet me institucionet e bashkëpunimit.			
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Të gjitha aktivitete kërkimore e shkencore të studentëve dhe stafit akademik si brenda dhe jashtë vendit mbështeten plotësisht financiarisht nga Universiteti gjë që konfirmohet nga tabelat dhe dokumentat që ishin bashkëlidhur raportit të brendshëm. (Evidenca .14)			
Konkluzione	Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga afirmimet në institucion konfirmojmë se institucioni ka përcaktuar qartë prioritetet e këtij programi dhe gjithashtu mbështet stafin dhe studentët në angazhimet kërkimore dhe jo vetëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Në takimet me stafin dhe studentët u diskutua në lidhje me mundësitë e mbledhjes së të dhënave kërkimore të studentëve në funksion të detyrave lëndore dhe projekteve kërkimore që plotësojnë kuadrin e objektivave të masterit shkencor të cilat sipas tyre kryhen në struktura mbështetëse dhe departamente të ndryshme të qendrave spitalore univesitare me të cilat institucioni ka marrëdhënie bashkëpunim si dhe në klinikat e fizioterapisë ku ata kryenin edhe praktikat e tyre. (Evidenca.25)
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e	Nisur nga kërkesat e stafit dhe studentëve, departamenti identifikon dhe siguron logjistikë dhe staf mbështetës për realizimin e objektivave në funksion të programit. Laboraret e institucionit shfrytëzoheshin

projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	plotësisht për analiza të karakterit kërkimor nga studentët dhe stafi si dhe falë marrëveshjeve institucionale u sigurohej mundësi hulumtimi më qëllime studimore.			
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Sikurse u konfirmua, vitet e fundit me zhvendosjen në kampusin e ri dhe rritjes së kapaciteteve logjistike, institucioni ka shtuar aktivitetet jashtëkurrikulare vecanërisht në fizioterapi. Gjithashtu dëshmuar se përveç konferencës së përvitshme studentore, leksioneve dhe seminareve të hapura të organizuar nga institucioni, studentët nxiten dhe mbështeten në pjesëmarrje edhe në aktivitete të ndryshme në të cilat Universiteti Aldent është partner. (Evidenca.13, 16)			
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Prioritet i programit të studimit konfirmohet se është formimi i fizioterapistëve të aftë për tregun vendas dhe të huaj.			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Njësia bazë dëshmon bashkëpunim me Urdhërin përkatës, merr informacion mbi procedurat dhe datat e provimeve praktike e klinike të licensimit si dhe orienton pedagogët fizioterapistë të punojnë me studentët për përgatitjen e tyre sa më të mirë për këtë proces. Gjithashtu u vu re se ka një bashkëpunim mes UAL dhe Shoqatës së Fizioterapisë në kuadër të aktiviteteve shkencore dhe aktiviteteve të përbashkëta që u konfirmua edhe nga presidenti F. D që ishte gjithashtu staf i këtij programi. (Evidenca.17)			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Programi i ciklit të dytë master i shkencave në "Fizioterapi klinike" është hartuar dhe zbatohet në përputhje në gjithë legjislacionin në fuqi për këtë cikël studimi			
Konkluzione	Njësia bazë dëshmon një angazhim maksimal për bashkëpunime me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. Organizon aktivitete të shumta kërkimore dhe profesionale konkretisht në fushën e fizioterapisë dhe bashkëpunon me urdhrat, shoqatat profesionale etj. për përgatitjen optimale të këtyre profesionistëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në insitucion u konfirmua se ka një angazhim që i gjithë procesi mësimor dhe veprimtaritë e tjera akademike të realizohen në përputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe duke respektuar lirinë akademike. Metodot e transmetimit të njohurive tek studentët të dëshmuara janë të shumta dhe në varësi të llojit/ specifikës së veprimtarive formuese. Ndërthurja e teorisë me praktikën në pothuajse të gjitha lëndët/ modulet e formimit bazë dhe specifik, përfshirja e studentëve dhe marrja e mendimeve të tyre, mundëson realizimin me sukses të veprimtarive të parashikuara. Fakulteti ka mundësuar infrastrukturën e nevojshme për të plotësuar nevojat që kanë lëndë/ module të ndryshme për tu realizuar sipas parashikimeve. Vlen të theksohet fakti i zhvillimit të procesit mësimor gjatë periudhës së Pandemisë nga Covid-19 gjatë së cilës institucioni dëshmoi se adaptoi metoda të mësimdhënies në distancë qysh në fazën e parë të mbylljes së institucioneve arsimore nëpërmjet platformës së edukimit në distancë, UAL e-learning.
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Stafi akademik u shpreh lirshëm për lirinë akademike në alternimin e metodave të mësimdhënies duke përdorur edhe module të edukimit në distancë, ku materialet e shtypura zëvendësohen me versione elektronike si dokumente, materiale hardcopy që zëvendësohen me versione elektronike, video, teste, forume, etj. Ndërthurja e orëve të teorisë, laboratorit, detyrave dhe projekteve brenda një moduli u kanë dhënë mundësi për përdorimin e një larmishmërie metodash mësimdhënie. (Evidenca. 19)
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Gjatë takimeve të ndryshme dhe vëzhgimit të infrastrukturës konfirmuam mundësitë e krijura për ndërthurjen e teorisë me praktikën dhe teknologjisë me mësimdhënien. Përdorimi i vazhdueshëm i mjeteve mbështetëse të teknologjisë në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies si dhe ndërthurja e shpjegimit teorik me demonstrime konkrete siguron rezultatet positive të të nxënit. Nga dokumentacioni dhe konfirmimet e stafit evidentuam se vitet të fundit stafi akademik ka marrë eksperiencë didaktike në institucione të huaja në kuadër të marrëveshjeve ose programeve si Erasmus+ në Turqi, Poloni, Lituani, Çeki etj.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në	Nga CV e personelit akademik u vu re se shumica prej tyre kanë një eksperiencë të gjatë profesionale dhe akademike dhe përshtat më së miri metodologjinë e mësimdhënies ndaj diveristetit të studentëve në auditor. Studentët gjithashtu konfirmuan se personeli akademik kujdeset që të përdorë metodologji të ndryshme mësimdhënie me qëllim përfitimin e njohurive në auditor si dhe duke i nxitur studentët drejt literaturave bashkëkohore.

qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	(Evidenca.20)
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Njësia kryesore në bashkëpunim me strukturat e tjera konfirmon vlerësimin e personelit akademik me qëllim përmirësimin e formave të mësimdhënies në përpunime me natyrën dhe profilin e lëndëve. Gjithashtu u theksua se për shkak të pandemisë, zhvillimi i veprimtarive nëpërmjet platformës së edukimit në distancë kanë qënë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. Mendimet e dhëna nga studentët qoftë në diskutimet e drejpërdrejta, takimet online, diskutime nëpërmjet platformës në formatet e saj apo nëpërmjet pyetësorit të realizuar dëshmojnë se kanë ndihmuar jo pak në përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies si gjatë ashtu edhe pas pandemisë. Shërbimi i tutoriatit akademik ishte një mundësi e përditëshme kontaktimi me studentët ku ata kishin mundësi të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre për përmirësim të dyanshëm që u konfirmua nga vetë studentët. (Evidenca.21.3)
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Në institucion u konfirmua se përmirësimi i vazhdueshëm në UAL e realizont nga njësia kryesore (FSHMT) që kujdeset vazhdimisht të sigurojë trajnime me lektorë vendas si dhe bashkëpunon me Zyrën e projekteve dhe marrëdhënieve me jashtë për mundësitë e trajnimit të stafit akademik jashtë vendit për aplikimin e formave, metodave alternative të mësimdhënies e mësimnxënies në përpunime me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. Eksperiencia shumëvjeçare e personelit akademik është e ndërthurur me personelin e ri duke mundësuar në këtë mënyrë vijueshmëri të traditës së krijuar por njëkohësisht implementimin e metodave të reja të mësimdhënies. (Evidenca.6.4)
Konkluzione	<i>Metodat e transmetimit të njohurive tek studentët të dëshmuara janë të shumta dhe në varësi të llojit/ specifikës së veprimtarive formuese. Ndërthurja e teorisë me praktikën në pothuaj të gjitha lëndët/modulet e formimit bazë dhe specifik, përfshirja e studentëve dhe marrja e mendimeve të tyre, mundëson realizimin me sukses të veprimtarive të parashikuara. Mendimet e dhëna nga studentët qoftë në diskutimet e drejpërdrejta, takimet online, diskutime nëpërmjet platformës në</i>

	<i>formatet e saj apo nëpërmjet pyetësorit të realizuar dëshmojnë se kanë ndihmuar jo pak në përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Njësia kryesore ka hartuar një sërë aktesh rregullatorë të cilat koordinojnë mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Në këto akte përshkruheshin mënyrat e vlerësimit të dijeve, detyra dhe përgjegjësitë që ka personeli akademik dhe studentët. Në rregulloren e programit të studimit, në dosjen e programit të studimit, në syllabuset e lëndëve dhe në procedurat e tjera për mbarrëvajtjen e procesit mësimor ishin përcaktuar të gjitha aspektet që lidhen me organizimin, zhvillimin dhe vlerësimin e veprimtarive formuese. (Evidenca.6.4)			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.	Studentët konfirmuan se vlerësimi i tyre realizohej gjatë gjithë vitit duke e vlerësuar atë për angazhimin gjatë zhvillimit të veprimtarive formuese si dhe në rezultatin e marrë në provimin final të lëndës/modulit. Format e testimit të njohurive janë për aktivizime në seminare, praktika, dorëzim projektesh, detyrash, teste të pjesshme dhe provimi final.			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Në vlerësimin përfundimtar të studentit në një disiplinë të caktuar merreshin në konsideratë të gjithë elementët përbërës të zhvillimit të lëndës: pjesa teorike, pjesa e seminareve, projektet, kontrollet e pjesshme, etj. Për çdo veprimtari studentët informoheshin në mënyrë të veçantë nga pedagogët respektivë. (Evidenca.7, tab 15)			
Konkluzione	Në dokumentat e bashkëlidhur raportit dhe nga vizita në insitucion u konfirmua se njësitë e anagzhuara për këtë program kanë hartuar dhe zbatuar rregullore për testimin e studentëve në të gjithë kompnentët e mësimnxënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.	Sipas të dhënave provimet në këtë program zhvilloheshin brenda periudhave të caktuara në strukturën mësimore të vitit akademik. Në fillim të çdo lënde/ moduli studentët dëshmuar se informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit. Mënyra e organizimit të provimit sipas rregulloreve të brendshme është në funksion të natyrës së disiplinës. Sipas syllabuseve dhe takimeve u konfirmua se në të gjitha lëndët dhe modulet aplikohet vlerësimi gjatë gjithë semestrit/ vitit duke informuar studentët me peshën specifike që kanë detyrimet që duhet të plotësohen nga studentët. Studentët gjithashtu u shprehën se janë të informuar mbi detyrimet që kanë në përfundim të lëndës/ modulit. <i>(Evidenca.6.3 , 12.2)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	U konfirmua se kanë të atashuar një sistem elektronik të përshtatur me versionet më të njohura të Moodle education që aplikohet gjëresisht ndër vite në institucionet ndërkombëtare. Ky sistem përdoret për dhënien e materialeve didaktike nga pedagogu dhe gjithashtu për vlerësime të detyrave praktike. Për sa i përket provimeve të parashikuara me shkrim gjithashtu dëshmuar se ruhet subjektiviteti duke sekretuar emrin e studentit me barkod të personalizuar.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Nota përfundimtare e lëndës ishte rezultat i konvertimit të pikëve të grumbullura nga të gjithë elementët e vlerësimit të përshkruar në syllabus.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Gjatë kontrollit të fletëve të provimit në varësi të situatës pedagogët u shprehën se shkruajnë komente për evidentimin e paqartësisë dhe mbahet në konsideratë për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjithashtu në faqen e modulit/ lëndës në UALeLearning pedagogu mund të komentojë sugjerime dhe këshilla për studentët me synim përvetësimin sa më të mirë të dijeve dhe arritjen me sukses të objektivave të lëndës.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	U konfirmua se provimet organizoheshin në auditore të bollshëm ku sigurohej distanca dhe nuk lejohet përdorimi i burimeve didaktike dhe elektronike dhe mbikqyrej nga të paktën dy pedagogë. Në mënyrë të vazhdueshme i gjithë stafi i UAL dëshmoi se angazhoheshin vazhdimisht me studentëve duke i këshilluar dhe orientuar veçanërisht në rastet kur ata kanë pjesë të modulit edhe detyra kursi për mënyrën se si duhet të strukturohet një punë e tillë.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Sipas rregulloreve dhe diskutimit me studentët u afirmua se rezultatet e provimeve dalin brenda një afati prej 7 ditësh dhe u prezantoheshin atyre në mënyrë individuale nga pedagogu i modulit. <i>(Evidenca.12.1, 12.2)</i>

Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studenti dëshmuar se sqarohen për çdo paqartësi për rezultatin e marrë. Sipas rregullores së njësisë, sekretarisë dhe provimeve nëse studenti nuk ishte i kënaqur me sqarimin e pedagogut ndiqte një procedurë ankimi për të cilën si stafi ashtu edhe studentët ishin të njohur.		
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimi, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Sipas procedurës së paraqitur studentët kanë të drejtë të njihen me gabimet dhe të kërkojnë rishikimin e notës duke u drejtuar me shkrim në Departament. Përgjegjësi i Departamentit shqyrton ankesën dhe kërkon rimarrje të studentit në provim nga një komision i posaçëm. Pedagogu i modulit dhe studenti njihen dhe marrin pjesë në këtë proces. I gjithë ky proces dokumentohet në departament. Na u dëshmuar se në këtë program studimi nuk kishte patur ndonjë rast kur ankimi i studentit të ketë arritur në nivele të përgjegjësit të departamentit.		
Konkluzione	<i>Sipas dokumentacionit dhe takimeve u qartësua se institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit. Stafi ashtu edhe studentët ishin të njohur me procedurat e vlerësimit dhe ankimit dhe nuk u dëshmuar asnjë precedent ku të ishin shmangur.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Në programin e studimit në vlerësim raportet midis veprimtarive formuese dhe formave të mësimdhënies ishin organizuar në mënyrë të tillë që të garantojnë thellimin e njohurive dhe të zhvillojnë aftësitë e thelluara profesionale e kërkimore të studentëve.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Për të zhvilluar më tej aftësitë e përdorimit të teknologjisë programi ka në përmbajtje module të formimit të përgjithshëm, teknologjisë dhe zbatimit të saj në mjekësi, etikës profesionale dhe komunikimit, administrimit të pacientit etj. (Evidenca. 18)
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli	Personeli akademik shprehu se integron të rehat më të fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit që ju jepet studentëve gjatë orarit normal të zhvillimit të modulit dhe jashtë tij kur është e nevojshme. Pedagogët gjithashtu konfirmuan faktin se rishikojnë çdo vit syllabusin dhe nisur nga analiza e zhvillimit të mësimi sygjerojnë ndryshime me synim përmirësimin e pritshmërive nga studentët.

akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.				
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Sipas planit mësimor modulet klinike shoqërohen me modulet rehabilituese të cilat përfshinin edhe orët e praktikave. Kjo vijueshmëri është kryer me synim arritjen e shprehive profesionale para se ato të zbatohen në pacientët klinik. Gjatë prezantimit të detyrave dhe projekteve lëndore të ngarkuara gjatë procesit mësimor, pedagogu së bashku me pjesën tjetër të grupit përfshiheshin në diskutime duke krijuar me studentët afritetin e kolegut për të shprehur ide dhe drejtime të ndryshme të trajtimit të diagnozave dhe aplikimit e metodave rehabilituese. Studentët dëshmuar se marrin pjesë aktive në aktivitete të kërkimit shkencor me projekte të zhvilluara me mbështetjen e institucionit . Nga tabelat e paraqitura si dhe nga zyra e projekteve u informuam se falë programeve ERASMUS dhe bashkëpunimeve ndërinstitucionale si studentët ashtu edhe stafi akademik kanë marrë eksperiencë ndërkombëtare			
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/ jashtë strukturës së programit të studimit.	Departamenti dëshmoi se stafi akademik i angazhaur në këtë program studimi të ketë eksperiencë klinike që shpesh përveç përmbajtjes së lëndës kanë realizuar leksione të hapura për studentët në kryesisht ditë të caktuara të shëndetit publik siç është Dita Ndërkombëtare e HIV-AIDS, e autizmit, e Diabetit etj. gjatë të cilëve studentë janë informuar për të reja të fundit në drejtim të parandalimit, epidemiologjisë, diagnostikimit dhe trajtimit të patologjive të ndryshme.			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Studentët janë përfshire në aktivitete shkencore jashtë vendit në formatin e shkollave verore mjekësore, shkollave dimërore mjekësore, trajnime multidisiplinare mjekësore të mbështetura nga institucioni. (Evidenca.14.3, 16)			
Konkluzione	Nga dokumentacioni i programit të studimit dhe takimet e ndryshme në institucion vlerësuam se programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synonë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Institucioni zotëron të gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimin e njohurive të studentëve. Të gjitha procedurat evidentohen në Rregulloren e Departamentit dhe Rregulloren e Sekretarisë. Mënyra e vlerësimit final për studentët e Masterit të Shkencave në “Fizioterapi Klinike” është përshkruar në rregulloren e programit dhe është në mbështetje të legjislacionit aktual për arsimin e lartë.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Sipas planit mësimor në vitin e dytë zhvillohet moduli i “Metodologjisë së kërkimit shkencor” që u jep njohuritë bazë për realizimin e një projektit kërkimor. Gjithashtu studentëve u jepet një dokumentacion mbi strukturën dhe modalitetet e aprovuara të diplomës të cilat ishin pjesë të evidencave të RVB dhe që gjithashtu u konfirmuan nga studentët.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohurisë dhe gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në vlerësimin përfundimtar komisioni i diplomimit, i ngritur nga Dekani merr në konsideratë arritjet e studentit në dy vitet e para, pra mesataren e ponderuar por vlerësimin kryesor e merr punimi dhe prezantimi i diplomës.
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Studentët orientohen për ngritjen e hipotezës dhe përcaktimin e tezës nga udhëheqësi dhe nga takimi me drejtuesit, stafin dhe studentët u konfirmua fakti që studentët asistohen në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, literaturën dhe gjithë procesit të punimit. (Evidenca.8.3)
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Për punimin e projektit të diplomës për çdo student përveç pedagogut udhëheqës departamenti ngarkon edhe një pedagog fizioterapist që asiston studentët në përzgjedhjen e literaturës, të përcaktimit të target grupit, gjatë mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të të dhënave.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Mbrojtja e temës së diplomës bëhet përpara komisionit të propozuar nga departamenti dhe miratuar nga Dekani i fakultetit. Provimi përfundimtar dhe punimi i diplomës vlerësohen me notë, nga një Komisioni i përbërë nga lektorë të Departamentit. Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj institucionit dhe ka përmbyllur detyrimet përmbyllëse të programit të studimit, pajiset nga institucioni me diplomën përkatëse, të shoqëruar me certifikatën e notave të marra gjatë

	studimeve universitare në UAL me suplementin e diplomës, të firmosura nga Dekani.			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në të ciklit të studimit dhe mbrojtjes së diplomës, studenti pajiset me diplomë universitare të cilësuar me ciklin dhe emërtimin e diplomës së marrë si dhe suplementin e diplomës. Forma dhe përmbajta e dokumentit të diplomës dhe suplementit i përmbahet udhëzimit Nr.10, datë 30.03.2020 “Për përcaktimin e elementëve përbërës dhe formën e diplomës ose certifikatës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit në regjistrin shtetëror të diplomave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor” i ndryshuar me Udhëzimin 14 datë 21.06.2022. të MASR dhe që gjendeshin bashkëlidhur RVB. (Evidenca.8.1)			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Konform udhëzimeve për ruajtjen dhe mirëadministrimin e të gjithë dokumentave akademike të Institucionit, UAL dëshmoi se arkivon kopje të dokumentacionit të studentit për një afat të pacaktuar dhe jep informacione me kërkesë dhe leje të tij ose të institucioneve shtetërore nëse kërkohen.			
Konkluzione	<i>Institucioni zotëron të gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimin e njohurive të studentëve. Studentët orientohen për punimin e tezës nga udhëheqësi dhe nga takimi me drejtuesit, stafin dhe studentët u konfirmua fakti që studentët asistohen në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, literaturën dhe gjithë procesit të punimit. UAL dëshmoi se arkivon kopje të dokumentacionit të studentit për një afat të pacaktuar dhe jep informacione me kërkesë dhe leje të tij ose të institucioneve shtetërore nëse kërkohen.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Nga dokumentacioni dhe takimet u konstatua se Universiteti siguron mundësitë optimale për kryerjen e praktikave laboratorike dhe ato klinike. Në universitet labororet e praktikës janë të ndarë sipas patologjive që trajtojnë; laborator neurologjik, laborator ortopedik dhe laborator pediatrik. Në këtë mënyrë praktikën e moduleve zhvillohen në labororet përkatëse dhe asistohen nga pedagogët e moduleve. Studentët gjithashtu mund të kryejnë praktikën jashtë ambjentëve të universitetit falë kontratave bashkëpunuese me qendra spitalore si dhe në klinika private. Këto praktika ndiqen nga fizioterapistët e shërbimeve
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet,	

garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	ku studentët frekutojnë si dhe kontrollohen në mënyrë periodike nga stafi pedagogjik i brendshëm i universitetit.			
Kriteri 3. Praktikë profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Studentët posedonin librezën e praktikës profesionale në të cilën ata përcaktonin ditët e frekuentimit të praktikës, patologjitë që kanë observuar dhe përshkruanin format e trajtimit të rasteve klinike. Kjo librezë nënshkruhet nga përgjegjësi i shërbimit në të cilën ata zhvillonin praktikën. Në fund të praktikës profesionale përgjegjësi i shërbimit përcaktonte vlerësimin mbi ecurinë individuale të secilit student. (Evidenca.6.5.1)			
Konkluzione	<i>Vlerësuar nga dokumentacioni dhe takimet, Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale. Praktikë laboratorike zhvillohen në laboratorët e mirëpajisura të institucionit, ndërsa ato profesionale nëpër spitale apo klinika fizioterapie falë marrëveshjeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës ka angazhuar staf akademik duke respektuar kriteret ligjore si dhe specialitetin e lëndëve/ moduleve dhe me synim përcjelljen e informacionit akademik në përputhje me ekspertizën e lektorëve. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi përputhet me ekspertizës me modulën si dhe ngarkesën akademike sipas vendimit të senatit. Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi mban përgjithësisht titullin “Doktor i shkencave”. <i>Stafi Msc i angazhuar në modulet rehabilituese janë specialistë të trajnuar të fushave specifike rehabilituese si Neurologji, Ortopedi etj. Nisur nga fakti që në vendin tonë nuk ka specialistë rehabilitimi të këtyre fushave me titull shkencor, institucioni ka bërë zgjedhjen e duhur në funksion të dijeve të studentëve. (Evidenca.22).</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Aktualisht janë angazhuar 21 PAE (2 Prof; 2 Prof.As; 9 Dr; 2 SPA; 6 Msc) dhe 11 PAK (52%) (2 Prof. As; 2 Dr; 7 Msc). <i>(Evidenca 2, tabela 7), 21-22 9 PAE dhe 14 PAK. 20-21, 8 PAE dhe 13PAK</i> Titullarët e lëndëve mbajnë minimalisht gradën Prof.asc. Në përzgjedhjen e stafit akademik sikurse u konfirmua nga drejtuesit i departamentit për të gjitha modulet është angazhuar staf akademik jo vetëm me eksperiencë në mësimdhënie por edhe në përputhje të specialitetit me modulën. <i>(Evidenca 7, tab 12)</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Stafi akademik i angazhuar jo vetëm në programin e studimit por edhe në gjithë institucionit deklaron se ka një qëndrueshmëri të konsiderueshme. Shumica e stafit ka minimalisht mbi 5 vjet në Universitetin Aldent. Kontratat e punë janë të përpiluara konform ligjeve dhe janë në dosjet e secilit. Përveç siguracioneve shëndetësore publike, institucioni prej vitesh siguron falas për stafin kartë të siguracionit privat ku përfshihen ekzaminime dhe vizita falas një herë në vit dhe ulje të konsiderueshme në këto shërbime gjatë gjithë vitit.
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe	Universiteti deklaron dhe mbështet me evidencë se ka një procedurë të mirëpërcaktuar për punësimin e personelit akademik që kalon në disa hallka të përcaktuara në në procedurën e rekrutimit. Fakulteti në bashkëpunim me zyrën e Burimeve Njerëzore mban rekordet e procesit të rekrutimit dhe të të dhënave të kandidatëve aplikues si dhe shpalljen e fituesve. Departamenti përfshihet në procesin e rekrutimit të stafit akademik i cili bëhet në disa faza. Kandidatet klasifikohen sipas pikëve të fituara dhe merret vendimi përkatës. Rektori emëron kandidatin fitues me një

përmbajtjen e programit të studimit.	urdhër të brendshëm. Punëdhënësi dhe punëmarrësi lidhin kontratën e cila depozitohet në Zyrën e Burimeve Njerëzore në dosjen personale të punëmarrësit. (Evidenca.22.4)
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Laboraret e fizioterapisë mirëmbahen dhe koordinohen nga stafi i fizioterapistëve të Departamentit Infermieri dhe Fizioterapi. Aktualisht, sikurse u dëshmua dhe konfirmohet nga tabelat, stafi i fizioterapistëve i angazhuar me kohë të plotë është në numër të konsiderueshëm gjë që mundëson një mirëmenaxhim të orëve praktike fizioterapeutike.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Në bazë të rregullores së Zyrës së Burimeve Njerëzore, kjo njësi mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik, ndihmës dhe administrativ. <i>Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore u përzgjodhën dy dosje në mënyrë rastësore, të cilat rezultuan të kishin disa mangësi në përditësime por, kontratat dhe kualifikimet e stafit përputheshin me deklaratimet e institucionit.</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Praktikat klinike janë një komponent i rëndësishëm i programeve mjekësore. Për realizimin me efektivitet të tyre UAL dëshmon se bashkëpunon me shumë institucione të ofrimit të shërbimeve shëndetësore si QSU “Nënë Tereza”, Spitali universitar obstetrik gjinekologjik “Koço Gliozheni”, Spitali Universitar i Traumës, Spitali universitar “Shefqet Ndroqi” si dhe klinika fizioterapie. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve angazhohen fizioterapistë që organizojnë dhe mbikëqyrin dhe monitorojnë studentët gjatë praktikave. Personeli i fizioterapistëve i cili ndjek praktikat profesionale të studentëve në qendrat spitalore ku ata janë përcaktuar si dhe në klinikat private ndjekin në dinamikë ecurinë e tyre, seriozitetin, angazhimin dhe frekuentimin në mënyrë që të japin vlerësimin përfundimtar të studentëve në librezën praktike në lidhje me pikat e mësipërme. (Evidenca.25)
Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë	

në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.				
Konkluzione	Personeli akademik që është angazhuar në këtë program studimi, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës ka angazhuar staf akademik duke respektuar kriteret ligjore si dhe specialitetin e lëndëve/ moduleve që ata mbulojnë. Praktikant klinike monitorohen nga stafi i departamentit dhe mbikqyren nga fizioterapistët e shërbimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Referuar RVB-së, Universiteti Aldent ka në dispozicion të procesit mësimor një sipërfaqe të konsiderueshme ku përfshihen salla leksionesh e seminaresh me kapacitet 30 deri 120 studentë, laboratorë, zyra të stafit e personelit. Godina aktuale është konceptuar si një kampus modern universitar, me standarte të larta logjistike. Gjatë vizitës në institucion u konstatua se sallat e leksioneve dhe seminareve ishin të pajisura me video-projektorë, kompjutera të lidhur me internet dhe tabela. Ndricimi natyral dhe artificial ishte i përshtatshëm. Dritaret janë me grila ose perde për të lejuar pamje të qartë gjatë projekcionit. Laboratorët janë të mirëpajisur me materiale, mulazhe, aparatura e mjete të nevojshme për aplikimin e procedurave rehabilituese. (Evidenca.15.2)
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Institucioni ka siguruar një laborator informatike në të cilin zhvillohen lëndët e informatikës dhe statistikës. Në këtë laborator zhvillohen programet bazë kompjuterike, përpunimet statistikore si dhe të kërkimit shkencor. Infrastruktura në dispozicion është e bollshme dhe plotëson të gjitha kushtet optimale të logjistikës dhe sigurisë të një procesi mësimor adekuat. Programet mjekësore kanë në numër të konsiderueshëm orësh praktike klinike që duhet të kryhen domosdoshmërisht pranë rasteve klinike konkrete dhe për këtë qëllim shfrytëzohen kapacitetet e Institucioneve shëndetësore me cilat UAL ka bashkëpunim. (Evidenca.15.1)
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave	(Evidenca.25)

formues të programit të studimit në tërësi.				
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.				
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.				
Konkluzione	<i>Universiteti Aldent ka në dispozicion të procesit mësimor një sipërfaqe të konsiderueshme. Laboratorët janë një nga investimet më të mëdha dhe asetet më të vlefshme në shërbim të plotë të studentëve dhe stafit akademik. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave laboratorike. Institucioni ka siguruar marrëveshje me strukturat spitalore për zhvillimin e praktikave klinike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të	Referuar RVB-së, biblioteka përmban rreth 10 mijë tituj librash në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, të klasifikuar sipas profileve dhe disiplinave. Për bibliotekën dhe teknologjinë gjatë vizitës në institucion konstatuam se janë vënë në dispozicion dy salla me kapacitet rreth 75 poste leximi, 50 poste interneti të pajisura me kompjuter. Literatura e detyruar u vihet në dispozicion në gjuhën shqipe dhe mund të jetë në format fizik (libër, dispencë) ose elektronik që u ngarkohet në

nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	faqen e modulit në platformën UALeLearning nga ku studentët mund ta shfrytëzojnë. Librat janë nga autorë dhe shtëpi botuese me famë si Elsevier janë një burim dijesh që shfrytëzohen maksimalisht nga stafi për përgatitjen e literaturës bazë po ashtu edhe nga studentët. (Evidenca.23.1)
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	Bazuar në kërkesat e departamentit, institucioni akordon cdo vit një fond të posacëm për pasurimin e literaturës në bibliotekë me libra apo traktate mjekësore. Ambjentet e bibliotekës vihen në dispozicion të studentëve në përputhje me nevojat e tyre, në përshtatje të orarit mësimor.
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Kapaciteti i bibliotekës është i mjaftueshëm për përdorimin e saj nga një numër i konsiderueshëm studentësh njëkohësisht.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nisur nga konsiderimet shëndetësore në përgjithësi dhe në veçanti të Covid-19, stafi i FSHMT porsiti për bibliotekën libra të edituar dhe botuar në dy vitet e fundit. Gjithashtu kërkohet nga stafi akademik i angazhuar përditësim i literaturës me materiale të 5 viteve të fundit. Literatura e të gjitha moduleve dhe burimet e paraqitur në syllabus aprovohet në fillim të vitit akademik nga njësia bazë. Biblioteka është në dispozicion të stafit dhe studentëve në mënyrë të barabartë në të gjitha programet dhe ciklet e studimit. Biblioteka ka një rregullore të brendëshme që respektohet me seriozitet për sa i përket mënyrës së tërheqjes, shfrytëzimit dhe trajtimit të librave. Nuk ka asnjë kufizim të shfrytëzimit të librave në bibliotekë që lidhet me programin apo fushën e studimit.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Studentët mund të shfrytëzojnë gjithë fondin e bibliotekës, pavarësisht nga fusha që studiojnë. (Evidenca.23)
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	

Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	UAL deklaron se është abonuar prej disa vitesh në bibliotekën “Hinari”, bibliotekë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë e cila shfrytëzohet nga stafi dhe studentët nëpërmjet kompjuterave të instaluar në ambientet e bibliotekës dhe lidhur pa kufizim në internet. Akses është siguruar në open library si https://www.research4life.org/, https://plus.al.cobiss.net/opac7/bib/search, në të cilën mund të aksesohen COLIB, CONOR, SGC, CORES, ELINKS – botimet elektronike me regjistrimet në COBI etj. Biblioteka e UAL është një aset i rëndësishëm që drejtohet dhe menaxhohet nga punonjës të specializuar në bibliotekoekonomi që ka në konsideratë ruajtjen dhe dokumentimin e librave. Çdo hyrje dhe dalje në bibliotekë dokumentohet në kartelat e stafit dhe studentëve ku shënohet titull i librit, autori, viti i botimit si dhe koha e marrjes dhe dorëzimit të librave. Stafi akademik orientojnë studentët për shfrytëzimin e librave duke u kërkuar atyre me rigorozitet përgatitjen e detyrave të kursit dhe duke evidentuar literaturën e shfrytëzuar.			
Konkluzione	<i>Literatura bazë u vihet në dispozicion në gjuhën shqipe dhe mund të jetë në format fizik (libër, dispencë) ose elektronik që u ngarkohet në faqen e modulit në platformën UALeLearning nga ku studentët mund ta shfrytëzojnë. Bazuar në kërkesat e departamentit, institucioni akordon cdo vit një fond të posaçëm për pasurimin e literaturës në bibliotekë me libra apo traktate mjekësore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion dhe duke naviguar faqen zyrtare të institucionit konstatoam se përveç platformës së UALe Learning në Moodle, institucioni ka disponon sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave të studentëve. Që nga momenti i regjistrimit të dhënat pasqyrohen në sistemin FxEducation të UAL nga sekretaria mësimore ku edhe pasqyrohet aktiviteti i studentit gjatë gjithë kohës së studimit.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit	Në sistemin e brendshëm FxEducation gjithashtu hidhen të dhënat e të gjithë stafit të angazhuar në varësi të njësisë kryesore, bazë dhe statusit të punësimit (Burimet njerëzore). Të dhënat në sistemin Fx kanë akses të kufizuar në varësi të kompetencave dhe pozicionit të punës.

administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Studentët e UAL informohen për gjithçka nëpërmjet platformës elektronike FxEducation që është një sistem i brendshëm menaxhimi të dhënash ku studentët logohen individualisht me të dhënat e tyre personale dhe mund të marrin çdo informacion që lidhet me performancën e tyre akademike dhe jo vetëm. Në këtë system ata futen nëpërmjet faqes zyrtare të Universitetit Aldent në rubrikën “portal i studentit” në çdo kohë dhe nga çdo pajisje elektronike e lidhur në internet. Gjithashtu në këtë platformë studentët regjistrohen online për provime në sesionet jo të rregullta të provimeve (vjeshtë, mbartje etj.) Koordinatorët e programeve kanë gjithashtu akses të dedikuar vetëm në programin që koordinojnë në bazë të afateve të caktuara në sistem për kontrollin ose përditësimin e të dhënave të kërkuara.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Në sistem, nëpërmjet një portali të posaçëm, studentët informohen jo vetëm me njoftimet për procesin mësimor por edhe për veprimtari të tjera apo informacione të nevojshme që lidhen me kërkimin shkencor, aktivitetet studentore, mobilitetet etj. Të dhënat në lidhje me veprimtaritë, leksionet, detyrat dhe materiale të tjera, personeli akademik dhe studentët mund të kryejnë nëpërmjet UALeLearning. UAL aplikon komunikimin e brendshëm institucional, përmes adresës elektronike që çdo aktor i institucionit disponon, përfshirë këtu të gjithë anëtarët e stafit akademik dhe administrativ (emër.mbiemër@ual.edu.al) dhe studentët (emër.mbiemër@student.ual.edu.al). (Evidenca.12.3)
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	UALeLearnig është një sistem është ndërtuar në mënyrë të tillë që të sigurojë akses, përdorim, informacion në kohë reale të materialeve në modulet e programit që studenti frekuenton. Zyra e IT mirëmban, ndjek dhe raporton në kohë reale për titullarët e institucionit duke gjeneruar raporte të ndryshme statistikore. Sistemi ka ndërfaqe shqip dhe anglisht dhe është i aksesueshëm edhe në versionin mobile.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Ndërkohë, FxEducation është një programi i sekretarisë mësimore ku mund të hyjë sekretaria, përgjegjësit e programeve, stafi akademik dhe studentët. Secili grup ka hapësirën e vet të aksesit ku mund të logohet me të dhënat personale dhe mund të marrë informacionin për të cilin ka akses.
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqa zyrtare e UAL është aktive në dy gjuhë; shqip dhe anglisht. Studentët dhe të gjithë të interesuarit mund të hyjnë lehtësisht dhe të marrin informacione për programet dhe për aktivitetin akademik të Universitetit. Gjithashtu faqja e Universitetit është e lidhur edhe me platformën eLearning dhe portalin e studentit ku studentët hyjnë me adresat dhe kodet e tyre individuale dhe marrin informacion për modulet.
Konkluzione	<i>UAL disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional e vë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik e administrativ për programin e studimit. UALeLearnig është</i>

	një sistem është ndërtuar në mënyrë të tillë që të sigurojë akses, përdorim, informacion në kohë reale të materialeve në modulet e programit që studenti frekuenton. Ndërkohë, FxEducation është një programi i sekretarisë mësimore ku mund të hyjë sekretaria, përgjegjësit e programeve, stafi akademik dhe studentët. Secili grup ka hapësirën e vet të aksesit ku mund të logohet me të dhënat personale dhe mund të marrë informacionin për të cilin ka akses.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në RVB citohet se, që në momentin e planifikimit të çeljes së programit të studimit, institucioni bën një parashikim të kostove dhe mundësive të mbështetjes financiare, me synim plotësimin e kushteve infrastrukturore dhe akademike për zhvillimin normal të procesit mësimor. Plani i financimit përshkruan të gjitha kostot e një programi studimi. Ai përmban financimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturore, pajisjet, materialet e konsumit për zhvillimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore e spitalore, fondin për pasurimin e bibliotekës dhe aksesin në bibliotekat on-line, kostot e auditeve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe mundësitë e mbështetjes financiare të projekteve të UAL.
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion.	Në përfundim të vitit kalendarik hartohen pasqyrat financiare të cilat tregojnë gjendjen e biznesit dhe masën e realizimit të Projekt-Buxhetit të përcaktuar. Në përfundim të përpilimit të pasqyrave financiare bëhet auditimi i përvitshëm i tyre. Në Shqipëri një universitet jo publik trajtohet si çdo biznes tjetër me gjithë të drejtat dhe detyrimet ndaj punonjësve, studentëve dhe ndaj shtetit. Duke qenë të tillë ai çdo vit harton pasqyrat financiare si Pasqyra e pozicionit financiar (Bilanci Kontabël), Pasqyra e performancës (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve), Pasqyra e Fluksit të mjeteve monetare dhe Pasqyra e Ndryshimit të Kapitalit Neto. Nga raportet financiare të UAL dëshmohej se, institucioni ka një gjëndje të qëndrueshme financiare dhe rritje ekonomike nga viti në vit, pa detyrime ndaj të tretëve individë, organizata, banka apo organe tatimore.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Rritja ekonomike, citohet në RVB, i ka shërbyer rritjes së cilësisë, shtimit të laboratorëve dhe përmirësimit të infrastrukturës së UAL, duke qenë një garanci për të ardhmen.
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e	Pavarësisht vështirësive të evidentuara gjatë pandemisë, treguesit makroekonomike të institucionit janë të qëndrueshëm. Mirëadministrimi i të ardhurave dhe hartimi planeve të detajuara, kanë dhënë mundësi institucionit të ruajë stabilitetin financiar dhe të garantojë realizimin e

studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	investimeve të parashikuara në infrastrukturë, laboratorë dhe logjistikën e nevojshme.			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	(Evidenca.14.2)			
Konkluzione	<i>Institucioni ka një gjëndje të qëndrueshme financiare dhe rritje ekonomike nga viti në vit, pa detyrime ndaj të tretëve individë, organizata, banka apo organe tatimore. Mirëadministrimi i të ardhurave dhe hartimi planeve të detajuara, kanë dhënë mundësi institucionit të ruajë stabilitetin financiar dhe të garantojë realizimin e investimeve të parashikuara në infrastrukturë, laboratorë dhe logjistikën e nevojshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni garanton nëpërmjet statutit të Universitetit “Aldent” dhe Rregulloreve të institucionit, zbatimin e politikave dhe procedurave në përputhje me legjislacionin në fuqi. Prej tyre vijon zbatimi i ligjit në Rregulloren e FSHMT, Rregulloren e Departamentit Infermieri dhe Fizioterapi, Rregulloren e Programit. Rregullorja e programit përcakton procedurën e pranimin, të drejtat dhe detyrimet e studentit, diplomimin, duke hartuar politika që garantojnë barazinë e studentëve.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Bazuar në kriteret kombëtare dhe propozimit të ardhur nga njësi bazë me vendim senati shpallen kriteret dhe modalitetet e pranimin të studentëve, të cilat u bëhen me dije aplikantëve përgjatë periudhës së informimit. Pranimi i studentëve bazohet në kriterin e mesatares së programit të studimit të nivelit të parë dhe intervistës në institucion, duke respektuar renditjen sipas pikëzimit. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sekretari, përkatsisht dosjeve të studenteve, GVJ evidentoi që dokumentacioni përmbush kriteret e pranimin të studentëve në ciklin e dytë të studimeve bazuar në nenin 76 pika 4, Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Kushtet dhe procedura e transferimit dhe njohjes së krediteve bëhen me dije nga koordinatori i programit. Ndërsa kriteret dhe procedurat e përparimit, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përgjegjësi e pedagogëve dhe lehtësohen e mbështeten nga tutori i grupit. (Takim me dekanin, stafin, studentët). Thëksojmë se diploma e nivelit të parë duhet të jetë e fushës. Para cdo fillim viti akademik, në afatet e përcaktuara nga MASR për aplikimet, pranë ambjenteve të Universitetit organizohet fushata e informimit. Stafi i ngarkuar për informim pret dhe sqaron të interesuarit me informacionin e nevojshëm për pranim. <i>(Evidenca.6.4)</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimin dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti	UAL deklaron se ndjek një politikë të barabartë pranimi për të gjithë kandidatët qofshin këta me aftësi të veçanta apo përkatësi të ndryshme.

akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Infrastruktura e re e Universitetit Aldent është e përshtatshme për t'u aksesuar si me këmbë ashtu edhe me mjete ndihmëse si rampa, ashensorë etj. për studentët me aftësi të kufizuara. (Evidenca.24.4)			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Studentët nga trojet apo shtetas të huaj që zotërojnë gjuhën shqipe, kryesisht nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi, Turqia, Greqia etj. orientohen për njehësimin e diplomës së ciklit të parë, plotësimin e detyrimeve të tjera ligjore si edhe për nevoja të tjera të lidhura me qëndrimin e tyre në Shqipëri.			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Institucioni citon në RVB dhe ka dokument evidencë se ndjek politikë mbështetëse për studentët romë dhe ballkano-egjiptian duke i ndihmuar si nga ana ekonomike ashtu dhe për integrimin sa më të mirë të tyre në rastet kur ata e dëshmojnë këtë përkatësi. Për studentët me nevoja dhe statuse të veçanta institucioni ofron lehtësira financiare të cilat parashikohen në kontratat individuale pas depozitimit të kërkesës në departamentin përkatës. UAL aktualisht siguron transportin falas me autobuset e vet të dedikuara nga qendra për në kampusin qendror dhe anasjelltas.			
Konkluzione	UAL ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. UAL deklaron se ndjek një politikë të barabartë pranimi për të gjithë kandidatët qofshin këta me aftësi të veçanta apo përkatësi të ndryshme. Disponon një procedurë për njohjen dhe transferimin e krediteve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ konstaton se, njohjen me rregulloren e programit, kushtet e frekuencimit, format e kontrollit të dijeve, konvertimin e pikëve në notë si dhe kriteret për të kaluar në vitin pasardhës e kryen përgjegjësi i programit i cili e ka detyrim institucional. Referuar RVB-së kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme dhe transferimit të krediteve përcaktohen në Rregulloren e UAL dhe specifikohen në Rregulloren e programit të studimit. Ekuivalentimi dhe njohja e krediteve të fituara nga kandidati prej studimeve të mëparshme bëhet nga Komisioni i Ekuivalentimit. (Evidenca.12.1.1)
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	

Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në syllabuset e moduleve përcaktohen elementët e vecantë të vlerësimit të njohurive, pikëzimi e konvertimi në notë. Studentëve iu bëhet me dije nga pedagogu përgjegjës për modulin, ditën e parë të mësimit. Në fillim të ciklit të studimeve, Përgjegjësi i programit informon studentët mbi procedurën e diplomimit, duke lënë kohë dhe hapësirë për zgjedhjen e fushës dhe në fillim të vitit të dytë, duke u këshilluar me pedagogët, studentët plotësojnë formularin përkatës. Cdo fillim viti, por edhe në cdo moment, studentëve dhe të interesuarve iu vihet në dispozicion informacioni mbi programin e studimit nëpërmjet faqes zyrtare, katalogut të shkollës, fletëve informuese, sekretarisë, stafit akademik dhe përgjigjesit të programit. Veprimtaria informuese intensifikohet në muajin shtator si periudhë informuese. (Evidenca.11) Studentët e UAL informohen për të gjitha nëpërmjet platformës elektronike FxEducation që është një sistem i brendshëm menaxhimi të dhënash ku studentët logohen individualisht me të dhënat e tyre personale dhe mund të marrin çdo informacion që lidhet me performancën e tyre akademike. Në këtë system ata futen nëpërmjet faqes zyrtare të Universitetit ALDENT në rubrikën “portal i studentit” në çdo kohë dhe nga çdo pajisje elektronike e lidhur në internet. http://portalonline.ual.edu.al/ (Evidenca.8.3), (Evidenca.4), (Evidenca.24.2), (Evidenca.24.3)			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.				
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.				
Konkluzione	Universiteti Aldent ka struktura të ngritura për dhënien e informacionit të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në këtë program studimi. Përgjegjësi i programit, tutori akademik dhe struktura të tjera përfshihen në procesin e informimit dhe orientimit të studentëve gjatë gjithë ciklit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ vëren se, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin e procesit mësimor, orët e teorisë dhe praktikës, si edhe sezonet e provimeve nëpërmjet kalendarit akademik të prezantuar nga përgjegjësi i programit si dhe në faqen zyrtare të institucionit.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për	Në lidhje me planin mësimor, lëndët dhe modulet, studentëve u vihet në dispozicion katalogu i shkollës, si dhe tabelat informuese në auditoret e leksioneve. Ata mund të marrin informacion edhe nga përgjegjësi i programit dhe tutori akademik në lidhje me veprimtaritë formuese.

lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe ofron mbështetje institucionale për të rritur potencialin dhe për t'u mirëorientuar në tregun e punës, nëpërmjet Zyrës së Karrierës, e ngritur enkas për këtë qëllim. Zyra zhvillon aktivitete të edukimit në vazhdim dhe mban kontakte me studentë e të diplomuar për ndjekjen e karrierës së tyre profesionale. (Evidenca.5.1)			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nëpërmjet platformës Fx Education, si sistem i brendshëm i menaxhimit të të dhënave, studentët logohen individualisht dhe njihen lehtësisht edhe në distancë me rezultatet e tyre gjatë procesit mësimor.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Sekretaria mësimore disponon të gjithë dokumentacionin e duhur për arritjet e studentëve në bazë të moduleve dhe cikleve akademike. Përveç dokumentacionit fizik të nënshkruar (proçesverbalet, regjistrat) rezultatet e studentëve disponohen edhe në formë elektronike në platformën FxEducation.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Puna e sekretarisë mësimore është në monitorim të vazhdueshëm nga administratori i institucionit në kuadër të hierarkisë dhe mbikqyrjes. (Evidenca.6.6)			
Konkluzione	Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin e procesit mësimor. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe ofron mbështetje institucionale për të rritur potencialin dhe për t'u mirëorientuar në tregun e punës, nëpërmjet Zyrës së Karrierës, e ngritur enkas për këtë qëllim. Studentët logohen individualisht dhe njihen lehtësisht edhe në distancë me rezultatet e tyre gjatë procesit mësimor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni, disponon në sekretarinë mësimore, statistikën vjetore me numrin e studentëve dhe të diplomuarve për çdo program studimi. (Evidenca 7, tab 23)
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në	Referuar vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për dy vitet akademike ishte: Për vitin akademik 2021 – 2022, 21 studentë; Për vitin akademik 2022– 2023, 20 studentë;

diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Universiteti, disponon gjithashtu, dokumentacionin vjetor me numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë “Fizioterapi Klinike”. Informacioni ruhet në kohë reale dhe menaxhohet në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave nga sekretaria mësimore, nëpërmjet Fx Education. Përveç ruajtjes së këtyre të dhënave në sistem online, shënohen manualisht të gjitha në regjistrat themeltar të programit të studimit. (Evidenca.12.3)			
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve në formën e dokumentacionit fizik (procesverbale, regjistra), si edhe në formën elektronike në platformën Fx Education. Në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave, në kushte të sigurisë së plotë, kanë të drejtë dhe detyrim të hedhin dhe modifikojnë informacionin persona të autorizuar në varësi të detyrës (sekretaria, dega mësimore,) dhe mund të hyjnë pa të drejtë manipulimi, një kategori e caktuar personash të autorizuar. (Vizitë në sekretarinë mësimore). Referuar RVB-së, institucioni harton një raport vjetor gjithëpërfshirës, për të gjitha njësitë dhe programet që ofron. Në këtë raport analizohet edhe cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje dhe sugjerohen masa për përmirësimin e cilësisë.			
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.				
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.				
Konkluzione	UAL vërteton se disponon në sekretarinë mësimore, statistikën vjetore me numrin e studentëve dhe të diplomuarve për cdo program studimi. të dhëna për ecurinë e studentëve në formën e dokumentacionit fizik (procesverbale, regjistra), si edhe në formën elektronike në platformën Fx Education. Përveç ruajtjes së këtyre të dhënave në sistem online, shënohen manualisht të gjitha në regjistrat themeltar të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloret e institucionit, garantohet e drejta e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendim marrëse dhe këshilluese të UAL. Studentët organizohen në Senatin Studentor, me një senator për cdo grup mësimor si dhe në komisione të tjera me përfaqësues studentësh si NJSBC, komisioni i kurrikulave, GVB, komisioni i kërkimit shkencor. Zëri dhe përfshirja e studentëve në proccese të rëndësishme akademike garantohet me pjesëmarrjen e tyre në komisione organe dhe komisione të rëndësishme si NJSBC, komisioni i kurrikulave, komisioni i kërkimit shkencor, GVB etj. (<i>Evidenca. 12.5</i>) Pyetësori i studentëve është një mënyrë tjetër ku ata mund të japin opinionin e tyre në mënyrë anonime dhe rreth cdo problematike që lidhet me institucionin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor. Studentët kanë të përshkruara të drejtat e tyre në dokumentat rregullatorë dhe ato respektohen me rigorozitet nga stafi akademik, administrativ, sekretaria dhe drejtuesit e institucionit. Ata kanë të drejtë të njihen me tezën e tyre të provimit me qëllim komentimin e rezultatit dhe kanë të drejtë të ndjekin të gjitha shkallët e ankimimit për rivlerësim.
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	
Konkluzione	<i>Studentët në UAL deklaruan se përfshihen në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore nëpërmjet përfaqësuesve të tyre nga Senati studentor. Ata kanë të drejtë të njihen me tezën e tyre të provimit me qëllim komentimin e rezultatit dhe kanë të drejtë të ndjekin të gjitha shkallët e ankimimit për rivlerësim.</i>
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet
	Përmbushet pjesërisht
	Përmbushet kryesisht
	Përmbushet plotësisht
	X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Nga RVB si dhe nga takimet me zyrat përkatëse konstatuam se Zyra e Informimit dhe zhvillimit të karrierës në institucion në bashkëpunim me përgjegjësit e programeve merr përsipër: Informime studentët e ardhshëm në lidhje me programet e studimit, standardet e pranimit të UAL-së dhe prespektivën personale e profesionale në përputhje me kërkesat dhe kriteret e vendosura nga Ministria e Arsimit. Informimin e studentëve dhe këshillimin e tyre që në momentin e regjistrimit me çdo informacion në lidhje me programet e studimit të ofruara në Universitetin Aldent. Avantazhet që secili prej programeve ofron si dhe mundësitë e punësimit në tregun e punës në përputhje me rregulloren e Zyrës së Këshillimit të Karrierës.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Nën përgjegjësinë e departamenteve organizohen aktivitete të tutoriatit për studentët. Në veprimtaritë e tutoriatit përfshihet i gjithë personeli akademik i programit të studimit. Tutorimi akademik përmbledh tërësinë e angazhimeve të tutorëve me student individual ose me grupe studentësh, mbi bazën e akordeve paraprake midis tyre. Shërbimi i Tutoriatit synon mbështetjen e studentëve për parandalimin e largimeve apo zgjatjen e kohës së studimeve përtej kohëzgjatjes normale të tyre, i orienton dhe i asiston studentët gjatë gjithë programit të tyre të studimit dhe nxit për një pjesmarrje më aktive të tyre në jetën universitare në të gjitha fushat dhe format e saj. <i>(Evidenca.12.6)</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Aktivitetet që zhvillohen në kuadër të mbështetjes dhe këshillimit të studentëve nga Zyra e informimit dhe këshillimit të karrierës në mënyrë të vazhdueshme përfshijnë: Leksione të hapura mbi “Metodat efektive të mësimnxënies”, ëorkshope “Hapat psikologjikë të menaxhimit të stresit para provimeve”. Projekti: “Fuqizo punësimin tënd” si pjesë e projektit të Këshillit të Europës i quajtur “ENTER”, përgjatë të cilit trajtohet e gjithë pjesa teorike dhe praktike në lidhje me ndërtimin e instrumentave të kërkimit të një vëndi punë si: përgatitja e një kërkese, përgatitja e një Cv/je, e një letre motivimi. Gjithashtu edhe përgatitja për intervistën e parë të punës, të gjithë komponentët të cilët duhen vlerësuar. Pjesëmarrja nëpër panairët e punësimit. <i>(Evidenca.24.1)</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të	Për studentët në prag diplomimi dhe studentët Alumni informohen dhe mbështeten nga kjo njësi përmes këtyre aktiviteteve: - Këshillim individual i karrierës. - Organizimi i tryezave të rrumbullakta, seminareve, konferencave të Alumnëve dhe studentëve aktualë.

programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	- Ndjekjen hap pas hapi e karrierës së të punësuarve përmes krijimit të një database me informacionin e tyre personal, kontaktet dhe vendin e punësimit. Gjithashtu formë tjetër e ruajtjes së kontakteve është edhe faqja në rrjetet sociale e emërtuar Alumni Aldent.			
Konkluzione	<i>Zyra e Informimit dhe zhvillimit të karrierës në institucion në bashkëpunim me përgjegjësit e programeve merr përsipër orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave gjatë viteve të studimit. Nën përgjegjësinë e departamenteve organizohen aktivitete të tutoriatit për studentët. Për studentët në prag diplomimi dhe studentët Alumni informohen dhe mbështeten nga Zyra e informimit dhe zhvillimit të karrierës përmes aktiviteteve të ndryshme si dhe ruan një database me informacionin personal, kontaktet dhe vendin e punësimit të studentëve pas diplomimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Në RVB, si edhe në takimin me përfaqësues të NJSBC, u cilësua se: Bazuar në Nenin 103 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë: "Institucionet e Arsimit të Lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë". Struktura dhe funksionimi i Njësisë së Sigurimit të Brendshme të Cilësisë (NJSBC) përcaktohen në Statutin e Institucionit të Arsimit të Lartë. Në zbatim të këtij neni, Senati Akademik i UAL ka miratuar Rregulloren e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. <i>(Evidenca.6.1)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Kontakti dhe monitorimi i vijueshmërisë së procesit mësimor nga përgjegjësi i departamentit, koordinatori i programit, kontakti i përditshëm i studentëve me tutorin akademik, pyetësorët e studentëve, formularët e performancës akademike janë mekanizma që identifikojë në vazhdimësi cilësinë e mësimdhënies. <i>(Evidenca v.21.2)</i> NJSBC çdo vit aplikon pyetësorin për studentët. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) është ngritur dhe funksionon konform përcaktimeve në ligjin aktual të arsimit të lartë dhe të statutit të UAL. <i>(Evidenca.21.3)</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë çdo fund viti akademik publikon raportin vjetor i cili përmban edhe plan masa për përmirësimin e treguesve me vlerë të ulët. Në institucion, herë pas here lind nevoja e ngritjes së grupit të auditimit për problematika të ndryshme në monitorimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit. Në çdo situatë të tillë grupi auditues harton një raport i cili i përcillet titullarit të institucionit. <i>(Evidenca.21.1.1)</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Universiteti Aldent në kuadër të planit të përgjithshëm strategjik rëndësi dhe vend të veçantë i kushton cilësisë së procesit mësimor si edhe të gjitha shërbimeve mbështetëse për realizimin e këtij procesi.
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	I gjithë stafi akademik është i informuar, merr pjesë dhe dëshmon angazhim maksimal në proceset e sigurimit të cilësisë akademike. <i>(Evidenca.5)</i>
Konkluzione	<i>Bazuar në legjislacion UAL ka ngritur NJSBC dhe ka hartuar udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit të cilësisë akademike. Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë çdo fund viti akademik publikon raportin vjetor i cili përmban edhe plan masa për përmirësimin e treguesve me vlerë të ulët si dhe promovim të arritjeve dhe vlerësimeve me të dhëna optimale.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Për të siguruar instrumentet e duhura të sigurimit të cilësisë, Universiteti Aldent në përputhje me normat ligjore në fuqi, Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit Aldent dhe të statutit neni 13, "Për organizimin e punës për kontrollin e brendshëm" ka hartuar document rregullator për N JSBC. Sigurimi i cilësisë në UAL është një proces i strukturuar dhe i organizuar që synon të sigurojë cilësinë e arsimit të ofruar programet e studimit që ofron institucioni. Ky proces përfshin vlerësimin e cilësisë nëpërmjet mbledhjes së të dhënave, analizën e të dhënave, identifikimin e problemeve dhe zhvillimin e planeve për përmirësim. Në këtë strukturë përfaqësohen të gjitha njësitë kryesore të universitetit. Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë zhvillon dhe zbaton politikat dhe procedurat e caktuara që synojnë të përmirësojnë cilësinë e arsimit. <i>(Evidenca.6.1)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Universiteti Aldent përmes Njesisë së Brendshme të Sigurimit të cilësisë e siguron zhvillimin e cilësisë së arsimit në pajtim me: - Ligjin mbi arsimin e lartë; - Statutin dhe rregulloren e Universitetit Aldent - Standardet shtetërore dhe udhëzimet për vlerësimin e jashtëm nga ASCAL Institucioni deklaron se prej kohësh ka bashkëpunim me aktorë të jashtëm për të vlerësuar performancën e stafit akademik dhe administrativ dhe institucionit në përgjithësi.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Në RVB citohet se institucioni ka krijuar mekanizmat e nevojshëm duke përdorur instrumente matëse dhe vlerësuese për vlerësimin periodik të programeve të studimeve dhe i ka përfshirë informacionet e nevojshme në të gjitha vlerësimet e brendshme të cilësisë. UAL i është nënshtruar periodikisht akreditimeve me ekspertë vendas dhe të huaj të aprovuara nga ASCAL. Të gjitha vlerësimet janë konsideruar nga institucioni si një hap për përmirësimet e mëtejshme, nuk janë kontestuar asnjëherë dhe janë respektuar e plotësuar në kohë gjithmonë rekomandimet e grupeve audituese. Bazuar në konstatimet dhe detyrat që dalin nga kontrollet dhe mënyrat e tjera të verifikimit të fakteve NJSBC harton raporte periodike si dhe një raport vjetor që na është vënë në dispozicion si evidencë.
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për	Institucioni deklaron se ka një hierarki funksionimi dhe mbikqyrje që mban nën kontroll të vazhdueshëm zbatimin me rigorozitet të rregulloreve. Dekani, përgjegjësi i departamentit dhe përgjegjësi i

pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	programit, përfaqësuesi i NJSBC në Fakultet koordinon dhe mbikqyrin vazhdimisht zbatimin e programit mësimor. I gjithë stafi akademik është i informuar, merr pjesë dhe dëshmon angazhim maksimal në proceset e sigurimit të cilësisë akademike. Modelet efektive të evidentuara nga të gjithë mekanizmat e vlerësimit promovohen dhe ekspertiza e tyre merret në konsideratë për vazhdimësinë e procesit. (Evidenca.5)			
Konkluzione	UAL ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me Statutin dhe rregulloren institucionale. Sigurimi i cilësisë në UAL është një proces i strukturuar dhe i organizuar që synon të sigurojë cilësinë e arsimit të ofruar programet e studimit që ofron institucioni. Ky proces përfshin vlerësimin e cilësisë nëpërmjet mbledhjes së të dhënave, analizën e të dhënave, identifikimin e problemeve dhe zhvillimin e planeve për përmirësim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Të gjitha gjetjet e vlerësimit vjetor që institucioni realizon, dëshmojnë që janë pjesë e raportit vjetor të NJSBC, i cili i vihet në dispozicion rektoratit. Këto të dhëna janë bazë për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe vetëvlerësimit. Gjithashtu institucioni kryen një vlerësim të brendshëm vjetor gjithëpërfshirës që përfshin gjithë programet, njësitë kryesore/bazë dhe ndihmëse që e paraqet në një raport vjetor të Universitetit i cili shërben si një historik për performancën institucionale. Anketimi i studentëve dhe stafit kryhej nga Instituti për Cilësi në Arsim që zbaton rregullat e ruajtjes së anonimatit me qëllim që konkuzionet të jenë sa më afër realitetit. Një rol të rëndësishëm në auditimin e institucionit sidomos në plotësimin e standardeve të stafit akademik dhe infrastruktures luan edhe kontrolli i përvitshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve për plotësimin e standardeve të mësipërme. Në përfundim të këtij kontrolli ky grup harton një raport që më pas i dërgohet institucionit dhe shërben si një udhërrëfyes i rëndësishëm sidomos për vitin pasardhës akademik.
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit,	Në raportin vjetor të NJSBC që na u vu në dispozicion përfshiheshin rezultatet e pyetësorëve që shoqëruar me grafik për çdo pyetje të drejtuar stafit ose studentëve duke vlerësuar përqindjet e çdo alternative për

motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	përgjigjet si dhe duke komentuar rezultatet. Në fund të paraqitjes së rezultateve të pyetësorëve kryhej një analizë mbi gjetjet dhe shprehen mundësitë e korigjimit apo përmirësimit dhe rekomandoheshin plan masash me synim rritjen e cilësisë akademike.
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Metodat e përdorura nga UAL për vlerësimin dhe realizimin me efektivitet të procesit mësimor deklarohen se janë të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Stafi akademik dhe Administrativ i Universitetit, fton studentët në diskutime të hapura, dhe ju mundëson atyre shprehjen e lirë të gjitha çështjeve që lidhen me procesin arsimor. Vlerësimi i studentëve bëhet në format e përcaktuara ligjore të cilat janë inkorporuar në Statutin, Rregulloren e përgjithshme dhe në programet e veçanta të studimit. Të gjitha këto janë pjesë e dokumentacionit mësimor (proçes verbale) të cilat janë në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore. Për vlerësimin e studentëve përdoren të gjitha format ligjore, përfshi këtu testimet, seminarët, detyra kursi, projektet, prezantime etj. Të gjithë studentët gjatë kryerjes së praktikave të tyre mbikqyren nga përgjegjësit e caktuar nga të cilët kërkohet vazhdimisht opinion në lidhje me frekuentimin, paraqitjen dhe cilësinë e punë së studentëve në ambientin klinik. Gjithashtu institucioni merr vazhdimish informacion nga autoritete si UISH për rezultatet e arritura nga provimi i VAP (Vlerësimi i arritjeve praktike) dhe provimi teorik nga QSHA për licensimin e studentëve.
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Metodat e tërthorta sipas pwrfaqwsueseve tw NJSBC janë: Sondazhe nëpërmjet pyetësorëve të studentëve, ku ata shprehen në kushte anonimiteti për të gjitha këto proçese. Sistemi i Tutorëve/Kujdestarëve të Grupeve të studentëve, mundësojnë në mënyrë permanente intervistimin e studentëve për të gjitha aspektet e proçesit mësimor. Stafit mësimdhënës i kërkohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik raporte mbi problematikat e hasura gjatë proçesit akademik, gjithashtu një feedback merret edhe nga mbikqyrësit e praktikave në lidhje me mirëfunksionimin dhe angazhimin e studentëve në shërbimet spitalore. (Evidenca.21.3)

Konkluzione	Universiteti Aldent vërteton se përdor mekanizma e procese të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit. Gjithashtu institucioni kryen një vlerësim të brendshëm vjetor gjithëpërfshirës që përfshin gjithë programet, njësitë kryesore/bazë dhe ndihmëse që e paraqet në një raport vjetor të Universitetit. Përdor metoda dhe instrumenta të drejtëpërdrejtë dhe të tërthorta për vlerësimin e komponentëve akademikë, rezultatet e të cilave analizohen dhe referohen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në përbërje të NJSBC ka nga një anëtar nga çdo Fakultet i Universitetit Aldent, një ekspert të jashtëm dhe një përfaqësues të unionit studentor. Megjithatë në funksion të procesit akademik është konfirmuar se ka një angazhim të shumëfishtë që përfshin personelin e pritjes, tutorët akademik, përgjegjës të programit, sekretarinë mësimore si dhe drejtuesit e njësive bazë që janë në kontakte të vazhdueshme me studentët dhe stafin e çdo programi studimi.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ u takua me aktorë të rëndësishëm të jetës akademike, Dekanin e Fakultetit, Përgjegjës të Departamentit, Përfaqësues të Stafit Akademik të brendshëm dhe të jashtëm, me Grupin e Vetëvlerësimit me përfaqësues të NJSBC dhe Zyrës së Karrierës. Në këto takime doli në pah organizimi i mirë i punës së përditshme, angazhimi optimal në procesin e akreditimit, motivimi, përgjegjësia dhe entuziazmi për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Duke qënë në unison, për një proces sa më korrekt dhe me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e veta, institucioni tregoi aftësi menaxhuese dhe drejtuese largpamëse dhe përforcoi ndjesinë pozitive se stafi jep më të mirën duke punuar e bashkëvepruar konform rregullave, në harmoni të plotë. Cdo grup është i pavarur, i barabartë, ushtron kompetencat në përputhje me autonominë që u siguron legjislacioni.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Edhe studentët shprehën pozitivisht dhe gëzojnë të drejtat e tyre, ashtu sic njohin edhe detyrimet akademike, cka u vu re gjatë bashkëbisedimit me përfaqësuesin studentor, përgjatë vizitës që GVJ zhvilloi në institucion. Kjo njësi ka në përbërje grupin përkates, i cili vlerëson periodikisht cilësinë dhe efikasitetin e veprimtarive mësimore-kërkimore për personelin akademik dhe studentët, si edhe aktivitetin administrativ të institucionit. Ky grup është i pavarur dhe siguron ushtrimin e
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të	

brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	kompetencave të strukturave përbërse të insitucionit në përputhje me kufijtë e autonomisë që ato gëzojnë sipas statutit. (Evidenca.21.1)			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.				
Konkluzione	Në procesin e sigurimit të cilësisë në Universitetin Aldent vihet re një përfshirje e gjerë dhe e interesuar për këtë process. Edhe pse në NJSBC ka nga një përfaqësues për çdo njësi, nga takimet u konstatua se gjithë stafi dhe studentët angazhohen maksimalisht për vlerësimin dhe rritjen e cilësisë. Ndërkombëtraizimi dhe mundësitë e mobilteteve jo vetëm të stafit akademik por edhe administrative kanë sjellë një frymë europiane dhe dëshirë për cilësi optimale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Në RVB citohet se politika që ndiqet për përmirësimin e cilësisë në bazë të kontroleve periodike është trajtimi dhe zgjidhja e çdo problemi që raportohet apo zbulohet nga auditimet e strukturave të institucionit apo nga pyetësorët e studentëve, vetë pedagogët apo hallkat më të larta drejtuese të institucionit.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe	Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë çdo fund viti akademik deklaron se publikon raportin vjetor i cili i përcillet senatit akademik. Ky raport i dorëzohet Rektorit i detajuar, ndërsa publikohet një përmbledhje e tij pa emra konkret. Për problematika e evidentuara diskutohen mundësitë e

legjislacionin për të dhënat personale.	përmirësimit në senat dhe në mënyrë individuale komunikohet për gjetjet problematike.			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raporti vjetor i NJSBC së bashku me plan masat e sugjeruara sipas rregullores dhe dëshmime të përfaqësuesve të NJSBC kalohet në senatin akademik i cili nxjerr në formën e vendimeve masat që duhet të merren për përmirësim. Paraqitën edhe sygjerrime për përmirësime të mëtejshme të procesit akademik			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Senati Akademik ndërmerr masat që vlerëson në kuadër të përmirësimit të cilësisë dhe ka autoritet për të monitoruar implementimin e tyre. Drejtuesit e njësive kryesore që gjithashtu janë anëtarë të senatit akademik ku raportojnë dhe marrin vendime në çdo takim periodik për ecurinë dhe përmirësimin e procesit mësimor, çdo fundviti akademik përpilojnë një raport vjetor ku identifikojnë problematika dhe veprimtaritë e marra në funksion të përmirësimit të cilësisë.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Nga takimet me stafin dhe përfaqësuesit e NJSBC u deklarua se shërbimi i tutoriatit akademik si dhe përgjegjësit e programeve luanë rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin për sigurimin e cilësisë në programin mësimor. (Evidenca.19)			
Konkluzione	<i>Evidentohet faksi se politika që ndiqet nga UAL për përmirësimin e cilësisë në bazë të kontroleve periodike është trajtimi dhe zgjidhja e çdo problemi që raportohet. Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë çdo fund viti akademik deklaron se publikon raportin vjetor i cili i përcillet senatit akademik. Ky raport i dorëzohet Rektorit i detajuar, ndërsa publikohet një përmbledhje e tij pa emra konkret. Senati Akademik ndërmerr masat që vlerëson në kuadër të përmirësimit të cilësisë dhe ka autoritet për të monitoruar implementimin e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i shkencave në “Fizioterapi klinike” ofruar nga institucioni i arsimit të lartë Universiteti “Aldent”

Pikat e forta:

1. Krahasuar me akreditimin e parë, institucioni ka pasuruar infrastrukturën me salla, auditore dhe laboratorë fizioterapie të pajisur me mjete të nevojshme që mundësojnë fizioterapistët të aftësohen dhe të fitojnë kompetenca profesionale të avancuara.
2. Institucioni dëshmon se ka lidhje të qëndrueshme dhe afatgjata me partner dhe institucione shëndetësore të cilët lejojnë praktikimin e studentëve fizioterapistë.
3. Programi mësimor ka një ndërthurje të teorisë dhe praktikës profesionale.
4. Staf akademik me eksperiencë profesionale edhe pedagogjike.
5. Aktivitete ekstrakurrikulare me ekspertë fizioterapistë për metoda të ndryshme rehabilitimi.
6. Mobilitet të studentëve dhe stafit akademik në programe si CEPUS, ERASMUS+
7. Përdorimi i teknologjisë nga studentët në platforma elektronike dhe programin e sekretarisë mësimore FxEducation.
8. Programi i studimit ofrohet nga një institucion tashmë i konsoliduar me eksperiencë disa vjecare dhe me profil tërësisht mjekësor.

Pika të dobëta:

1. Mungesë e stafit fizioterapist me titull dhe grada shkencore. **(Standardi IV.1)**
2. Shfrytëzimi i ulët i literaturës së huaj nga libraritë on line nga studentët. **(Standardi II)**
3. Mungesa e burimeve financiare alternative nga projekte. **(Standardi IV)**

Rekomandime:

1. Aplikime për projekte kombëtare dhe ndërkombëtare
2. Bashkëpunime me institucione jo vetëm arsimore ndërkombëtare për punësimin e studentëve të diplomuar.
3. Asistencë ndaj stafit akademik për kualifikimin e vazhdueshëm brenda dhe jashtë vendit.

Completion of the evaluation of the second cycle study program Master of Science in "Clinical Physiotherapy" of Higher Education Institution "Aldent" University

Strong points and affirmations:

1. Compared to the first accreditation, there has been an environment enriched with activities, auditing and similar physiotherapy laboratories with the necessary tools and enabling physiotherapists to acquire advanced professional competences.
2. The institution proves that it has a long-term relationship and permission with the partner of the school institutions of the school that practice as a physiotherapist.
3. The curriculum has a combination of theory and professional practices.
4. Academic staff with professional and pedagogical experience.
5. Extracurricular activities with physiotherapists for different rehabilitation methods.
6. Mobility of students and academic staff in CEPUS, ERASMUS+ programs
7. Use of technology from the electronic platform and program of the FxEducation educational secretariat.
8. The study program is offered by an already consolidated institution with several years of experience and a controlled profile.

Weak points:

1. Lack of physiotherapist staff with scientific titles and degrees.
2. Low use of foreign literature by online bookstores by standards.
3. Lack of alternative financial resources from projects.

Recommendations:

1. Applications for national projects and statement.
2. Cooperation with non-educational institutions for the work of graduate students.
3. Assistance to the academic staff for the future qualification inside and outside the country.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X